

1. Informacion i pergjithshem

Organizimi

Shoqeria "GERMANI" sh.p.k eshte krijuar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me Vendim Gjykate Nr.29108 date te gjykates Tirane dt.01.01.2003.

Subjekti ka qene subjekt i Takses vendore te Biznesit te vogel deri ne vitin 30.12.2008 dhe ka qene i pezulluar deri 31.03.2013, pas kesaj kohe u rregjistrua si subjekt i biznesit te madh.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr 9901 dt.14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", dhe legjislacioni ne fuqi.

Objekti dhe Kontributet

Shoqeria "GERMANI" sh.p.k ka si objekt : Import eksport dhe tregtim me pakice e shumice te mjeteve dhe makinerive te ndryshme mekanike bujqesore si dhe pjeseve qe sherbejne per kete fushe Tregtim, montim, mirëmbajtje, riparim ashensorë dhe shkallë të lëvizshme, shërbime për riparime speciale të marmitave të të gjitha tipeve të veturave. Ortaket e shoqerise jane Ismail Germani qe zotron 50% te kapitalit ne shumen 50.000 leke dhe Arben Germani qe zoteron 50% te kapitalit ne shumen 50.000 leke

Administrimi

Shoqeria drejtohet nga administratori i vetem i shoqerise z.Ismail Germani, dhe eshte rregjistruar ne organin tatimor te qytetit te Durrës me NIPT K31427549Q

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin 25/2021 dt.10.05.2021 'Për kontabilitetin

dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te kosos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera sipas "parimit te drejtave te kostatuara". Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (lekë). Veprimet jane hedhur ne menyre kronologjike dhe te kompjuterizuar ne programin "FINANCA 5". Veprimet jane ngurtesuar me 31.12.2022

Shifrat e paraqitura ne pasqyrat financiare te vitit 2022, jane te krahasueshme me ato te vitit 2021, pasi nuk ka ndryshime ne politikat kontabile.

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2022 eshte zbatuar formati i SKK-2

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, ne hartimin e pasqyrave financiare te vitit 2022, janë si më poshtë:

Vijimesia e veprimtarise ekonomike e subjektit eshte e siguruar, pasi nuk ka ne plan nderprerjen e aktivitetit te tij ekonomik.

Kompensimi midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka, ndersa midis te ardhurave she shpenzimeve ka vetem kur lejohen nga SKK.



PASQYRAT FINANCIARE 2022

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

Kuptueshmeria e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote, per te qene te qarta dhe te kuptueshme per perdorues te jashtem, qe kane njohuri te pergjitheshme dhe te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.

Materialiteti eshte vleresuar nga ana jone, dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zera materiale.

Besueshmeria per hartimin e pasqyrave financiare eshte e siguruar, pasi nuk ka gabime materiale, duke zbatuar parimet e meposhteme:

- Parimin e paraqitjes me besnikeri.
- Parimin e perparemise se permbajtjes ekonomike mbi formen.
- Parimin e paanshmerise pa asnje influencim te qellimshem.
- Parimin e maturise pa optimizem te tepruar, pa nenvleresim dhe mbivleresim te qellimshem.
- Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te Pasqyrave Financiare.
- Parimin e qendrueshmerise per te mos ndryshuar politikat kontabel.
- Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara, mbeshtetur ne dokumentacionin justifikues. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftueshme ne marrjen e perfitimeve. Shpenzimet e periudhes ushtrimore jane te krahasueshme dhe te lidhura me te ardhurat e te njejtes periudhe.

Monedhat e huaja :Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos fillestare te amortizuar dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2022 jane 1 euro=114.23leke, 1 dollar= 107.05 leke.

Tatimin mbi fitimin:Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin raportues, bazohet mbi fitimin e tatueshem, i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2022 eshte 15 %

Kërkesat për t'u arkëtuar:Kërkesat për t'u arkëtuar, llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre nominale te amortizuar. (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).



PASQYRAT FINANCIARE 2022

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

Pasivet financiare:Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parà, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre nominale të amortizuar neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet Afatgjata materiale:Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjetër te aktiveve te qendrueshme. Normat e perdorura jane sipas ligjit 8438 dt.28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" ne ndertesat 5 % te vleres se mbetur, per pajisjet informatike 25 % te vleres se mbetur dhe per aktivet e tjera 20% te vleres se mbetur.

Gjendjet e inventaret: Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi.

Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve, vleresuar sipas metodes se koston mesatare te ponderuar.

3. Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve te bilancit

Çelja e vitit 2022 rakordon me mbylljen e vitit 2021. Shumat e kolones "Ushtrim i Mbyllur" si ne aktiv dhe ne pasiv kapin shumen 78,794,706 leke.

4. Aktivet Afatshkurtera

Aktivet afatshkurtera ne pasqyrat financiare te vitit 2022 paraqiten sipas zerave me poshte:

4.a Mjetet monetare ne arke dhe banke me 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 jane si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Para ne dore	1,476,082	44,717
Para ne Banka	406,852	6,721,843
Totali	<u>1,882,934</u>	<u>6,766,560</u>

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve ta paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes, dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventareve fizike te monedhave. Tepricat e llogarive ne monedhe te huaj, jane perkthyer ne leke duke perdorur kursin e kembimit te dates 31.12.2022 te Bankes se Shqiperise, 1 euro=114.23leke, 1 usd=107.05 leke.

4.b Të drejta të arkëtueshme perfaqesojne vleren e detyrimeve debitore, te cilat ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2022, deklarohen si vijon:



	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Nga aktiviteti I shfrytezimit	0	26,356,502
Te tjera	266,391	699,575
Totali	<u>266,391</u>	<u>27,056,077</u>

4.b1 Te tjera të drejta të arketueshme perfaqesojne vleren e detyrimeve debitore, te cilat ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2022, deklarohen si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
TVSH	266,391	43,039
Tatimi mbi fitimin	0	656,536
Totali	<u>266,391</u>	<u>699,575</u>

Shuma ne vleren 266,391 leke perfaqson TVSH te paguar ne blerje nga subjekti rakordon me SIT-in.

4.c Iventaret perfaqesojne gjendjen e iventareve ne fillim dhe ne fund te vitit ushtrimor si me poshte:

Inventari

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Materiale te para	37,999,813	32,774,945
Mallra	2,158,041	1,891,996
Parapagime per inventar	0	348,151
Totali	<u>40,157,854</u>	<u>35,015,092</u>

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit, dhe me inventarin fizik te kryer ne fund te ushtrimit me 31.12.2022. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrje-daljet e inventarit, jane tranzituar ne llogarite e rezultatit, me menyren e inventarit te perhershem. Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit , eshte perdorur metoda e kostos "mesatare te ponderuar". Shuma e inventareve te paraqitur ne postin "Mallra" perfaqeson stokun e materialeve qe perdoren ne procesin e ndertimit, te vleresuar me koston e tyre historike.

5. Aktivet Afatgjata materiale (AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale per vitin ushtrimor 2022, ne pasqyrat financiare financiare paraqiten si me poshte:

	Ndertime dhe toka	Ndertime dhe toka	Te tjera	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>		<i>Aktive te Trupezuara</i>		
Gjendje 01.01.2021	105,000.00	23,306,420.92	818,483.34	24,229,904.26
Shtesa	0.00	0.00	27,666.67	27,666.67
Pakesime	0.00	(3,241,434.13)	0.00	(3,241,434.13)
Gjendje 31.12.2021	<u>105,000.00</u>	<u>20,064,986.79</u>	<u>846,150.01</u>	<u>21,016,136.80</u>

Amortizimi



PASQYRAT FINANCIARE 2022
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

Gjendje ne 01.01.2021	40,049.00	13,794,875.00	438,003.00	14,272,927.00
Shtesa llogaritur	12,990.00	1,571,489.00	86,087.00	1,670,566.00
Pakesime		(1,855,736.00)		(1,855,736.00)
Gjendje ne 31.12.2021	53,039.00	13,510,628.00	524,090.00	14,087,757.00
<i>Vlera neto 01.01.2021</i>	64,951.00	9,511,545.92	380,480.34	9,956,977.26
<i>Vlera neto 31.12.2021</i>	51,961.00	6,554,358.79	322,060.01	6,928,379.80

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe I aktiveve afatgjata materiale (AAM-ve), te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme, jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike, qe shoqeria ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2022. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SNK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes, dhe ne daten e mbylljes se bilancit, me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar. Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve, dhe per rrjedhoje nuk ka llogaritur zhvleresime. Metodrat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura nga shoqeria, jane te njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

6. Detyrimet afatshkurtera

6.a "Detyrimet afatshkurtera" ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2022 paraqiten si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Arketime në avancë për porosi	12,161,265	11,193,300
Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	54,000	5,072,871
Te pagueshme ndaj punonj.dhe sig.shoqerore	1,536,271	1,531,014
Të pagueshme për detyrimet tatimore	28,793	5,850
Te tjera te pagueshme	-	2,889,845
Totali	13,780,329	20,692,880

"Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per shumen 54 000 leke, per blerjen e mallrave dhe te sherbimeve, te cilat jane te palikjuhuara ne fund te vitit ushtrimor, dhe do te likujdohen ne 12 muajt e ardhshem. Kjo llogari eshte e azhornuar dhe shumta e llogarive analitike, te mbajtura per cdo furnitor, eshte e barabarte me llogarine sintetike. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane vleresuar realisht.

Detyrimet per "Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sig.shoqerore" jane perfshire detyrimet e shoqerise ndaj punonjesve dhe detyrimi per sigurimet shoqerore te muajit dhjetor 2022 ne shumen 82,863leke dhe pagat ne shumen 1453408 leke, qe jane likuiduar ne muajin janar 2023.

6.a.1 "Të pagueshme për detyrimet tatimore" ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2022 paraqiten si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Tatimi mbi fitmin	27,493.00	0.00
Tatimi mbi te ardhurat personale	1,300	5,850

"GERMANI" Shtepi Durrës



Totali	28,793	5,850
--------	---------------	--------------

6.a.2 "Huete afatgjata" ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2022 paraqiten si vijon:

Huete afatgjata	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Te tjera te pagueshme	8,367,276	41,069,717
Titujt e huamarrjes	15,516,343	6,428,572
Totali	23,883,619	47,498,289

"Huete afatgjata" pasqyron detyrimin qe subjekti ka ndaj ortakeve te shoqerise dhe detyrimin ndaj Institucionit te kredise.

7. Kapitali dhe rezervat

Kapitalet e vet ate shoqerise per vitin ushtrimor 2022, paraqiten sipas tabelës me poshte:

"Kapitali aksioner" (fillestar) i shoqerise i paraqitur ne bilanc, eshte injejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise, dhe te depozituara ne QKR. Per vitin 2022 kapitali nuk ka pesuar ndryshime. "Rezervat e tjera" gjate vitit ushtrimor 2022 jane rritur sipas vendimit te ortakut, per perdorimin e fitimit te vitit 2022, dhe te depozituar ne QKR dhe ne organet tatimore. Fitimi i vitit financiar perfaqeson fitimin neto te periudhes, pasi i eshte zbritur tatimi mbi fitimin. Ndryshimi I posteve te ndryshme te kapitalit, ne menyre dinamike paraqiten ne pasqyren perkatese te "Kapitaleve te veta", ndersa fitimi (Humbja) e vitit financiar paraqitet ne "Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve".

8. Fitimi (humbja) e vitit financiar

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Katitali I nenshkuar	100,000	100,000
Rezerva ligjore	10,000	10,000
Rezerva te tjera	10,493,537	9,682,432
Fitimi/Humbja e vitit	968,074	811,105
Totali	11,571,611	10,603,537

8.a. Te ardhurat nga aktiviteti I shfrytezimit

Te ardhurat e realizuara gjate periudhes ushtrimore 2022, paraqiten sipas zerave te tabelës me poshte:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	32,622,387	25,828,780
Totali	32,622,387	25,828,780

"Te ardhurat nga aktivitetin e shfrytezimit", jane vleresuar me vleren e drejte te shumës se arketuar ose te arketueshme, duke marre parasysh shumën e skontimeve, ose rabatet e ofruara, dhe perfaqesojne shitjet e mallrave te realizuara, te dokumentuara me fature tatimore shitje, te cilat nuk rakordojne me te dhenat e sistemit informatik te organit tatimor ne shumën **1,044,378** leke ,qe jane parardhenie nga klientet me fature tatimore

8.b Shpenzimet

Shpenzimet e realizuara si konsumi i materialeve, mallrave, shpenzimet e tjera nga veprimtaria e shfrytezimit, jane rregjistruar me shumën e paguara ose te pagueshme sipas dokumentacionit baze, faturave tatimore. Shpenzimet e personelit jane pasqyruar sakte si shpenzim me vleren e



PASQYRAT FINANCIARE 2022

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

realizuar dhe te dokumentuar. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2022, jane pasqyruar ne pasqyren perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimet e analizuara sipas zerave paraqiten si me poshte:

8.b.1 Shpenzimet per "Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme" sipas zerave, paraqiten si vijon:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Mallra dhe materiale te para	19,028,142	14,239,773
Shpenzime te tjera materiale	1,701,049.00	789,681.00
Totali	20,729,191	15,029,454

8.b.2 "Shpenzime te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit" sipas zerave analitike, paraqiten si vijon:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Mirembajtje dhe riparime	222,533	424,892
Primi I sigurimit	150,294	44,000
Sherbime te tjera	239,842	278,590
Personel jashte ndermarjes	180,000	180,000
Publicitet, reklama	0	721,016
Transport per blerje	2,000	6,000
Sherbime bankare & kom Garancie	104,541	121,158
Taksa	77,647	65,648
Te tjera	900	0
Vlera neto e AAM te shitura	2,309,623	0
Shpenzime te padokumentuara sipas ligjit	0	113,300
Gjoha dhe demshperblime	2,922	1,995
Totali	3,290,303	1,956,599

Sqarimi i blerjeve

SHPENZIMET			
BLERJET SIPAS FDP DHE SIT	27,935,512		
1.Blerje per investime	27,667	-	
Blerje investime brenda vendit pa tvsh (25)	-		
Importe te perjashtuara te investimit pa tvsh (26)	-		
Importe te investimit me tvsh 20% (30)			
Blerje te investimit brenda vendit me tvsh 20% (34)	27667		
2.Blerje mallra dhe sherbime etj	27,907,845		
Blerje te perjashtuara (24)	3,551,841		
Importe mallra me shkalle tatimore 20% (28)			

"GERMANI" S.p.A. Durrës



PASQYRAT FINANCIARE 2022
 Shenime per Deklarimet Financiare
 Periudha nga 1 Janar deri 31 Dhjetor 2022

	18,147,639		
Blerje nga furnitor vendas me shkalle tatimore 20% (32)	6,208,365		
SHPENZIME SIPAS BILANCIT		ME	PA
		FATURA	FATURE
DEKLARATA E TATIM FITIMIT	31,482,962		
Ndryshimi i gjendjes se Produktit te gatshem	-	-	-
Mallra lend te pare dhe materiale te konsumueshme	19,028,142	19,028,143	
Te tjera shpenzime materiale	1,701,049	1,589,859	111,190
Pagat + sig shoq	4,053,765		4,053,765
Amortizimi	1,670,566		
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	3,290,303	816,736	2,473,567
Interesa	306,425		
Humbjet nga kembimet valutore	1,432,712		1,432,712
TOTALI SHPENZIMEVE	31,482,962	21,434,738	8,071,234
Ndryshimi gjendjes Inventarit	-	5,490,913	
Kliente me fature paradhenie	-		
			-
	31,482,962	26,925,651	8,071,234

Diferenca blerje me FDP me blerje Bilancit eshte **1,009,861**
 Diferenca prej 1,009,861 leke vjen si rezultat i differences ndermjet vleres doganore te mallrave me koston faktite te tyre , per efekt te references, si dhe te transportit nderkombetar te mallrave nga furnitoret vendas, te deklaruar dy here, nje here ne Librin e blerjeve dhe heren tjeter ne Deklaraten doganore te importit.

8.b.4 „Shpezimet per personelin“ paraqiten si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2022</u>	<u>31 Dhjetor 2021</u>
Paga	3,473,676	2,921,923
Sigurime shoqerore	580,089	487,961
Totali	<u>4,053,765</u>	<u>3,409,884</u>

8.b.4 „Te ardhurat dhe shpenzimet financiare“ paraqiten si me poshte:



- **Te ardhurat dhe shpenzimet nga kembimet valutore** ne fillim dhe ne fund te periudhes ushtrimore paraqiten si vijon:

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Fitim nga kembime valutore monetare	160,735	57,695
Humbje nga kembimet valut. monetare	-1,593,446	-1,839,803
Totali	-1,432,711	-1,782,108

-Te ardhura dhe shpenzime nga interesat

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Te ardhura nga interesat	175	0
Shpenzime nga interesat	(306,600)	0
Totali	-306,425	0

8.c. Fitimi neto

Shpenzimet per tatimin mbi fitimin dhe fitimin e tatueshem, paraqiten sipas tabelës me poshte:


Fitimi (Humbja) e vitit financiar

	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2021
Fitim Bruto	1,139,426	974,587
1.Shpenzime te pa njohura	2,922	115,295
a.Gjoha, penalitete, demshperblime	2,922	1,995
b.Shpenzime te padokumentuara sipas ligjit	0	113,300
Baza llogaritjes Tatimit	1,142,348	1,089,882
% e tatim Fitimit	15	15
Tatim Fitimi	171,352	163,482
Fitimi Neto	968,074	811,105

Tatimi mbi fitimin e ushtrimit eshte llogaritur mbi fitimin e tatueshem, i cili eshte rregulluar me shpenzimet e panjohura, sipas legjislacionit fiskal.

9.Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se hartimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin e vitit 2022 eshte rritur shifra e afarizmit dhe shifra e fitimit tregtar.



**Auditues ligjor
(Xhevdet Hyseni)**

Xhevdet Hyseni

**Administratori
(Ismail Germani)**

ISMAIL GERMANI



[Handwritten signature]